



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 1, Datë 22.05.2012

Për

Miratimin e projekt-idesë të "Projekti Hidroenergjitik mbi lumin Devoll".

Në zbatim të pikës dh, neni 4, kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", neni 8, 13, të "Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), në mbledhjen e tij të datës 16.05.2012, mori në shqyrtim projekt-idenë për "Projektin hidroenergjitik të Devollit", i hartuar nga firma projektuese "Devoll Hydropower" ku bëjnë pjesë digat e Banjës, Kokel dhe Moglicë për këtë objekt. Projekt-ideja për "Projektin hidroenergjitik mbi lumun Devoll", u paraqit nga firma projektuese "Devoll Hydropower".

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha pasi diskutoi Projekt-idenë e Skemës së lumit Devoll" dhe të digave Banjë, Kokel, Moglicë, pas sqarimeve e plotësimeve nga ana e firmës projektuese "Devoll Hydropower":

Vendosi:

Të plotësohen kërkesat e mëposhtme:

1. Projekt-ideja e paraqitur nuk përputhet me skemën e miratuar në dokumentin e konçesionit (ligji nr.10083 dt. 22.02.2009). Ka një rishikim të skemës dhe si pasojë ka dalë një skemë e re që shfrytëzon lumin duke filluar nga kuota 650 m e jo nga kuota 810 m që ka qenë në koçension dhe digat parashikohen të jenë në akse të tjerë e me nivele të tjera të ujit në rezervuare.
Mendojmë se është e domosdoshme që të kemi miratimin e skemës së re nga autoriteti kontraktues, sipas ligjit.
2. Vlera e punimeve të preventuara mendojmë se është e vogël prandaj kërkohet të sqarohet, rishikohet e të plotësohet për të gjitha objektet.

3. Të plotësohen kërkesat e nenit 8, pika 1/1.3 "Relacioni mbi karakteristikat e valës që krijohet në luginën poshtë digës", si dhe pika 2 e nenit 8, të vendimit 147, datë 18.03.2004, pasi në dosjen tuaj mungojnë.
4. Baza e të dhënave metereologjike (rreshjet) dhe hidrologjike duhet të konfirmohen zyrtarisht nga një institucion shqipëtar i specializuar dhe konkretisht Insituti Hidrometeorologjik.
5. Për plotësimin e nevojave të Bujqësisë për periudhën e ujitjes, të merren në konsideratë kërkesat e Ministrisë së Bujqësisë me shkresat nr.110 prot dt. 12. 01. 2009, dhe shkresa nr.3096/1 dt. 27.10.2009. Njëkohësisht do kërkonim që prurjet maksimale të shkarkimeve të shmangin përmbytjet në bieftet e poshtme.
6. Plotësimet dhe saktësimet lidhur me studimin sizmiologjik për secilën digë janë si vijon:
 - 6/1 Studimi mbi rrezikun sizmik ("Sizmik Hazard") tani, në versionin e rishikuar të studimit, jepet mjaft më i plotë, i bazuar në trajtime dhe metodika bashkëkohore. Konform dhe rekomandimeve të ICOLD-it, jepen vlerësimet e veçanta sidomos për tërmetin OBE (tërmetin bazë të punës-operimit) me RP = 500vjet, dhe për tërmetin MDE ("tërmetin e projektimit") me RP= 2000vjet. Por në përmbledhje ("Summary") në fq. 68 të relacionit 6, duhet të dalë e qartë, në terma sasior, vlera "pik" e akseleracionit (PGA) për tërmetin MDE. Mendojmë ndërkaq, se në fq.67 ka një konkluzion jo të saktë për studimin e cituar të prof. Muço-s.
 - 6/2. Mendojmë që konkluzionet e studimit mbi rrezikun sizmik nuk pasqyrohen qartë, se si ato janë përdorur si të dhëna hyrëse ("input"), në pjesën pasuese të studimit (projektit), pra në llogaritjet inxhinierike sizmike të digave në përgjithësi dhe në vlerësimin e qëndrueshmërisë të skarpatave në veçanti, duke nxjerrë prej këtyre konkluzionet përkatëse dhe koficientët e sigurisë, referuar veprimit të tërmeteve OBE, MDE si dhe MCE (me RP=10 000 vjet).Këto aspekte të ri-paraqiten në mënyrë bindëse.

Mbas plotësimit të këtyre kërkesave KKDM në çdo kohë do të mblidhet për miratimin e projekt-idesë "Projektin Hidroenergjitik mbi lumin Devoll".

Shpresojmë në mirëkuptimin Tuaj

Me respekt,

KRYETAR
PERI DISHNICA

